



RRJETI I
SHËRBIMEVE
SOCIO-SHËNDETËSORE

● Bashkia Korçë

RRJETI I
SHËRBIMEVE
SOCIO-SHËNDETËSORE

Bashkia **Korçë**

Informacioni u mblodh nga
Organizata “Gruaja në Zhvillim”



Gruaja
në Zhvillim
Korçë

Hartimi dhe publikimi i këtij dokumenti u realizua me mbështetjen e Projektit
“Shëndet për të Gjithë” të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC”



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	5
Shërbimi Social Shtetëror Rajonal Korçë	6
Drejtoria e Kujdesit Social Korçë Qendrat Ditore për të Moshuarit	10
Drejtoria e Kujdesit Social Korçë Qendrat Ditore të Fëmijëve	12
Qendra Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, Bashkia Korçë	14
Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Korçë Qendra Ditore “Shërbimet Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjen”	16
Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor, Korçë	20
Mary Potter, Kujdesi Shëndetësor Familjar Shërbimi Paliativ	22
Fondacioni “Mëshirë pa kufi për Shqipërinë” Qendra Komunitare Ditore	24
Fondacioni Kennedy Qendra Ditore për Fëmijët	26
Fondacioni Kennedy Shërbim në Banesë për të Moshuarit (shërbim privat)	28
Dorcas Aid International Albania	30
Fondacioni Misioni Emanuel Qendrat ditore për të moshuarit në qytetin e Korçës	32
Qendra Rezidenciale e të Moshuarve “Vila Kennedy” (Shërbim Privat)	34
Qendra Shëndetësore Kennedy (Shërbim privat pjesërisht i subvencionuar)	36
Fondacioni “Mëshirë pa Kufi për Shqipërinë” Strehëza e Emergjencës për Rastet e Dhunës	38
Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Korçë	40
World Vision Korçë Shërbime sociale për fëmijët, Qendra Sportive Korçë	42
Qendra Sportive Korçë SHA	44
Mitropolia e Shenjtë	46

Hyrje

Rrjeti i Shërbimeve Socio-Shëndetësore në Bashkinë Korçë është një nismë e mbështetur nga Projekti “Shëndet për të Gjithë” i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), në zbatim të “Strategjisë Kombëtare të Kujdesit Shëndetësor Parësor” 2020-2025. Dokumenti synon të fuqizojë shërbimin socio-shëndetësor në Kujdesin Shëndetësor Parësor (KSHP), përmes përmirësimit të qasjes dhe cilësisë së shërbimeve sociale, veçanërisht të atyre që synojnë arritjen e popullatave të cënueshme.

Ky dokument përbën një mjet pune që u vjen në ndihmë punonjësve socialë pranë KSHP-së për të lidhur ose referuar pacientët drejt shërbimeve plotësuese, që nuk mund të ofrohen nga Qendrat Shëndetësore. Njëkohësisht, ky dokument u vjen në ndihmë aktorëve të tjerë lokalë të shërbimeve sociale dhe shëndetësore, si Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Kujdesit Social në Bashki, Shërbimi Social Shtetëror Rajonal dhe Organizatat e Shoqërisë Civile në Bashkinë Korçë, duke u mundësuar njohjen dhe koordinimin më të mirë të shërbimeve në zonën e tyre të mbulimit.

Rrjeti i Shërbimeve Shëndetësore dhe Sociale në Bashkinë Korçë u përgatit nga Organizata “Gruaja në Zhvillim” Korçë gjatë periudhës Nëntor – Dhjetor 2023.

Për realizimin e këtij dokumenti, falënderojmë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Drejtorinë e Kujdesit Social në Bashki, Shërbimin Social Shtetëror Rajonal dhe Organizatat e Shoqërisë Civile në Bashkinë Korçë, si bashkëpunëtorë të rëndësishëm në jetësimin e këtij procesi.

Shërbimi Social Shtetëror Rajonal Korçë

Lloji i institucionit	Publik
Adresa	Bulevard Rilindasit, Nr. 73, Korçë
Përfaqësues ligjor i institucionit	Entela Fejzo Cel.: +355 69 244 0410 Email: entela.fejzo@sherbimisocial.gov.al https://www.sherbimisocial.gov.al/ (faqja e SHSSH Kombëtar)
Personi i kontaktit	Entela Fejzo Cel.: +355 69 244 0410 Email: entela.fejzo@sherbimisocial.gov.al
Mbulimi gjeografik	Rajoni Korçë (Bashkitë Korçë, Pogradec, Devoll, Pustec, Ersekë)
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 1993

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- Qëllimi i shërbimit**
 - Rritja e cilësisë së jetës për personat vulnerabël në rajonin e Korçës.
- Fushat e shërbimeve**
 - Shërbime shoqërore (Institucione të Përkujdesjes Sociale)
 - Shërbime të pagesave për Ndhimë Ekonomike dhe Aftësinë e Kufizuar
- Llojet e shërbimeve**

Shërbime shoqërore (Institucione të Përkujdesjes Sociale):

 - Monitorim të standardeve të shërbimeve sociale në rajon të ofruara nga Institucionet e Përkujdesjes Sociale, publike dhe jopublike, rezidenciale dhe ditore që ofrojnë shërbime për fëmijët (të trafikuar, me probleme social-ekonomike), të rritur (me probleme social-ekonomike), të moshuarit 65+, gratë e dhunuara.

Shërbime të pagesave për Ndhimë Ekonomike dhe Aftësinë e Kufizuar:

 - Administrim të Regjistrat Elektronik për aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror (përfshirë dosjet e të moshuarve për azil);
 - Programim dhe detajim të fondeve të ndihmës ekonomike (shqyrton dosjet e përfituesve);
 - Programim dhe detajim të fondeve të pagesës për personat me aftësi të kufizuar (shqyrton dosjet e përfituesve);
 - Shpërndarja e bonusit të bebes.

Shërbimet e monitoruara nga DRSHSSH Korçë

Shërbime Sociale për Fëmijë

- Shërbime Rezidenciale për Fëmijë (2 qendra)
- Shërbime Ditore për Fëmijë (2 qendra)

Shërbime Sociale për të Moshuar

- Shërbime Rezidenciale për të Moshuar (1 qendër)
- Shërbime Ditore për të Moshuar (1 qendër)
- Shërbim në Familje (1 qendër)

Shërbime për Persona me Aftësi të Kufizuar

- Shërbime Rezidenciale për PAK (1 qendër)
- Shërbime Ditore për PAK (2 qendra)
- Shërbim në Shtëpi (1 qendër)

Shërbime Sociale për Gra të Dhunuara/Viktima Trafikimi

- Shërbime Ditore
- Shërbime Rezidenciale

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese

- Fëmijët
- Familjet
- Persona me aftësi të kufizuar
- Të moshuarit
- Gratë e dhunuara/viktima të trafikimit

Kriteret kualifikuese

Për fëmijët:

- Jetimë që nuk janë në institucione
- Fëmijë të vendosur në shërbimin e kujdestarisë

Për përfituesit e ndihmës ekonomike:

- Kryefamiljarë të papunë;
- Persona që jetojnë në kushte minimale jetese;
- Persona që nuk zotërojnë pasuri të paluajtshme si shtëpi të dytë, vila, makina;
- Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.

Për përfituesit e pagesës së Aftësisë së Kufizuar:

- Paraplegjikë dhe tetraplegjikë
- Persona me aftësi të kufizuar, të paaftë për punë
- Invalidët e punës
- Rezidentë në qarkun e Korçës.

Për të moshuarit:

- Të moshuar 65+
- Të vetmuar,
- Të moshuar që nuk zotërojnë pasuri të paluajtshme (tokë, shtëpi)

Për gra të dhunuara/viktima të trafikimit:

- Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit të tyre;
- Viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes;

Identifikimi i përfituesve

- Përmes shërbimeve publike të përkujdesjes dhe mbështetjes sociale në rajon.

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve

- 17 punonjës

Financues i shërbimit

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Burime të tjera të ardhurash

- Kontribute nga donacione e sponsorizime

Pagesa nga përfituesit

- Nuk ka

Koordinimi me shërbime të tjera

- Njësitë Administrative për përfituesit e ndihmës ekonomike
- Mjekët e familjes dhe specialistët për skemën e Aftësisë së Kufizuar
- Drejtoria e Kujdesit Social, në Bashkinë Korçë
- Inspektoriat i Punës
- Organizata Ndërkombëtare që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve, familjeve, dhe fuqizimin e komuniteteve
- Organizatat jofitimprurëse në rajon

O Drejtoria e Kujdesit Social Korçë

Qendrat Ditore për të Moshuarit

Qendrat ditore për të moshuarit janë qendra publike nën administrimin e Bashkisë Korçë, Drejtoria e Kujdesit Social. Kjo fishë përmbledh informacionin e nevojshëm për 4 qendrat që administrojnë kjo Bashki, meqë kanë gamë të njëjtë shërbimesh, por zona të ndryshme mbulimi.

Lloji i institucionit Publike

Adresa Rruga “Ligor Brace”, Lagjja nr. 7, Korçë
Rruga “Blloku i Ri i Sportit”, Lagjja nr. 10, Korçë
Rruga “Veteranët”, Lagjja nr. 12, Korçë
Rruga “Rexhep Telhaj”, Lagjja nr. 15, Korçë

Përfaqësues ligjor i institucionit **Marjana Lara**
Drejtoreshë e Kujdesit Social, Bashkia Korçë
Cel.: +355 69 250 4959 | Email: mariana.lara_tdh@yahoo.com

Personi i kontaktit **Gabriela Haska**, Bashkia Korçë
Cel.: +355 67 692 3490 | Email: gabrielahaska22@gmail.com

Mariela Baraku, Dorcas
Cel.: +355 69 605 6420 | Email: ofice@emanuelmision.org

Ervin Dallaku, Fondacioni Emanuel
Cel.: +355 69 440 3608 | Email: e.dallaku@emanuelmision.org

Mbulimi gjeografik Qyteti i Korçës

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2009

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

○ **Qëllimi i shërbimit** ➤ Zbutja e problemeve psiko-sociale dhe shmangia e izolimit social për moshën e tretë në qytetin e Korçës.

○ **Fushat e shërbimeve** ➤ Shërbime psiko-sociale në qendrat ditore
➤ Shërbime shëndetësore në qendrat ditore

○ **Llojet e shërbimeve** Shërbime psiko-sociale:
➤ Shërbime sociale ditore për të moshuarit (socializim përmes aktiviteteve ditore me dhe për të moshuarit);
➤ Biseda individuale apo në grup me synim mbështetjen psikologjike të të moshuarve;

Shërbime shëndetësore:

- ↘ Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në qendër (matje të glicemisë dhe tensionit arterial);
- ↘ Edukim shëndetësor për të moshuarit si të menaxhojnë sëmundjen kronike, të ushqyerit, ruajtjen e higjienës personale, etj..

GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese** ↘ Të moshuarit (65+ vjeç)
- Kriteret kualifikuese**
 - ↘ Të moshuar që jetojnë në qytetin e Korçës
 - ↘ Të moshuar të vetmuar
 - ↘ Të moshuar në vështirësi social-ekonomike
- Identifikimi i përfituesve**
 - ↘ Përmes stafit të qendrave dhe punës në terren
 - ↘ Përmes institucioneve koordinuese
 - ↘ Përmes komunitetit

INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve** ↘ 2 punonjës
- Financuesi i shërbimit**
 - ↘ Këshilli i Qarkut Korçë
 - ↘ Bashkia Korçë
 - ↘ Fondacioni Emanuel
 - ↘ Fondacioni Dorcas Aid, Shqipëri
- Burime të tjera të ardhurash** ↘ Nuk ka
- Pagesa nga përfituesit** ↘ Nuk ka
- Koordinimi me shërbime të tjera**
 - ↘ Fondacioni Dorcas Albania dhe Emanuel
 - ↘ Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Shëndetësor Parësor
 - ↘ Bashkia Korçë dhe institucionet në varësi
 - ↘ Organizata të tjera lokale joqeveritare

O Drejtoria e Kujdesit Social Korçë

Qendrat Ditore të Fëmijëve

Qendrat ditore të fëmijëve janë qendra publike nën administrimin e Drejtorisë së Kujdesit Social, Bashkia Korçë. Në Bashkinë Korçë janë 3 qendra ditore për fëmijët. Kjo fishë përmbledh informacionin për të trija këto qendra ditore meqë ofrohet e njëjta gamë shërbimesh, por në zona të ndryshme mbulimi.

Lloji i institucionit Publike

Adresa Lagjja 10, Rruga “Blloku i Ri i Sportit”, Korçë
Lagjja 8, Rruga “Ligor Braçe”, Korçë
Lagjja 15, Rruga “Gaqo Avrazi”, Korçë

Përfaqësues ligjor i institucionit **Mariana Lara**, Drejtore e Kujdesit Social, Bashkia Korçë
Cel.: +355 69 250 4959 | Email: mariana.lara_tdh@yahoo.com

Personi i kontaktit **Nertila Lika**, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF), Bashkia Korçë
Cel.: +355 69 577 9670 | Email: nertilahabasllari@live.com

Mariela Baraku, Fondacioni Emanuel
Cel.: +355 69 605 6420 | Email: office@emanuelmission.org

Ervin Dallaku, Fondacioni Emanuel
Cel.: +355 69 440 3608 | Email: e.dallaku@emanuelmission.org

Mbulimi gjeografik Qyteti i Korçës

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2014

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

Qëllimi i shërbimit

➤ Fuqizimi dhe integrimi i fëmijëve në bashkinë Korçë

Fushat e shërbimeve

➤ Shërbime sociale
➤ Shërbime edukimi dhe integrimi

Llojet e shërbimeve

Shërbime sociale:

- Aktivitete sociale dhe integruese për fëmijët (trajnime mbi aftësimin për jetën, ekskursione, kampe verore, festime të ndryshme);
- Edukim shëndetësor (trajnim për higjienën personale dhe ushqyerjen e shëndetshme);
- Klasa prindërimi për prindërit e fëmijëve.

Shërbime edukimi dhe integrimi:

- Kujdes për fëmijët pas orarit shkollor (mbështetje me procesin e kryerjes së detyrave, ofrim i vaktit ushqimor, etj.);

GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese**
 - ↘ Fëmijët
 - ↘ Prindërit
 - ↘ Komuniteti
- Kriteret kualifikuese**
 - ↘ Fëmijë nga familje të komunitetit rom dhe egjiptian
 - ↘ Fëmijë nga familje me probleme social-ekonomike
 - ↘ Fëmijë që nuk ndjekin rregullisht arsimin fillor dhe 9-vjeçar
 - ↘ Prindër të fëmijëve që frekuentojnë qendrat ditore
- Identifikimi i përfituesve**
 - ↘ Përmes Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, Bashkia Korçë
 - ↘ Institucionet arsimore
 - ↘ Prindër të fëmijëve në nevojë për këtë shërbim
 - ↘ Organizata joqeveritare lokale

INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numëri i punonjësve**
 - ↘ 8 punonjës
- Financuesi i shërbimit**
 - ↘ Këshilli i Qarkut Korçë
 - ↘ Dorcas AID Shqipëri
- Burime të tjera të ardhurash**
 - ↘ Organizata jofitimprurëse
 - ↘ Global Albania Foundation (një fond i përkohshëm)
- Pagesa nga përfituesit**
 - ↘ Nuk ka
- Koordinimi me shërbime të tjera**
 - ↘ Shërbimet e Bashkisë Korçë
 - ↘ Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashkinë Korçë
 - ↘ Shërbime të tjera me fokus fëmijët (publike apo jo)
 - ↘ Institucionet arsimore (shkollat)
 - ↘ Komuniteti

Qendra Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara, Bashkia Korçë

Lloji i institucionit	Publik
Adresa	Rruga "Partizani", Lagjja nr. 4, Korçë
Përfaqësues ligjor i institucionit	Dhimitra Palla Cel.: +355 69 231 8827 Email: dhimitra.palla@hotmail.com
Personi i kontaktit	Dhimitra Palla Cel.: +355 69 231 8827 Email: dhimitra.palla@hotmail.com
Mbulimi gjeografik	Bashkia Korçë
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 2020

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- Qëllimi i shërbimit**
 - Integrimi i fëmijëve me Aftësi të Kufizuara në shoqëri.
- Fushat e shërbimeve**
 - Shërbime ditore rehabilituese (fizike, të të folurit, etj.)
 - Shërbime psiko-sociale
- Llojet e shërbimeve**
 - Shërbime ditore rehabilituese:**
 - Terapi zhvillimi dhe rehabilituese: zhvillim dhe rehabilitim fizik, të të folurit (logopedi), etj.;
 - Shërbime edukative për mbajtjen dhe rritjen e aftësive fizike dhe sociale (autonomia dhe higjiena personale);
 - Edukim i familjarëve/kujdestarit në mënyrë që ushtrimet rehabilituese të replikohen edhe në shtëpi.
 - Shërbime psiko-sociale:**
 - Aktivitete socializimi dhe okupacionale, rekreative-kulturore;
 - Mbështetje psikologjike për familjarët/kujdestarët e Personit me Aftësi të Kufizuara (PAK): trajnime dhe këshillime periodike, individuale dhe në grup;
 - Edukim për të drejtat njerëzore për Personat me Aftësi të Kufizuara.

GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese**
 - Fëmijët me probleme të zhvillimit dhe aftësi të kufizuara të grupmoshës 3-16 vjeç;
 - Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Kriteret kualifikuese**
 - Fëmijë me aftësi të kufizuar intelektuale dhe fizike të moshës 3 – 16 vjeç (autizëm, çrregullime të të nxënit, Sindroma Down, para-tetra-hemi plegjikë, dëmtime të pjesshme shqisore, etj.);
 - Fëmijë që nuk frekuentojnë çerdhet, kopshtet apo shkollat për shkak të aftësisë së kufizuar;
 - Fëmijë që nuk frekuentojnë institucione ose qendra të tjera publike ose private të përkujdesjes shoqërore;
 - Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të cilët vijnë nga familje me gjendje social - ekonomike jo të mirë.
- Identifikimi i përfituesve**
 - Identifikimi kryhet përmes institucioneve koordinuese (të përshkruara më poshtë)

INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve**
 - 6 persona
- Financuesi i shërbimit**
 - Bashkia Korçë
- Burime të tjera të ardhurash**
 - Donacione të vogla në materiale për shërbimin e përditshëm nga organizatat e shoqërisë civile.
- Pagesa nga përfituesit**
 - Nuk ka
- Koordinimi me shërbime të tjera**
 - Drejtoria e Kujdesit Social, në Bashkinë Korçë
 - Zyra Vendore Arsimore dhe institucionet e saj të varësisë
 - Organizata të tjera jofitimprurëse lokale
 - Shërbimi Social Shtetëror Rajonal, Korçë
 - Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Shëndetësor Parësor

O Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Korçë

Qendra Ditore “Shërbimet Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjen”

Lloji i institucionit Publik

Adresa Bulevardi “Fan Noli” Nr. 57, Lagjja 4, Korçë
Cel.: +355 68 305 4030 | Email: shmffkorce@gmail.com

Përfaqësues ligjor i institucionit **Marjana Lara**
Drejtoreshë e Kujdesit Social, Bashkia Korçë
Cel.: +355 69 250 4959 | Email: mariana.lara_tdh@yahoo.com

Personi i kontaktit **Mamica Shishi**
Koordinatorja e shërbimit
Cel.: +355 69 585 4868 | Email: mamica.muka@gmail.com

Mbulimi gjeografik Bashkia Korçë

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2021

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- **Qëllimi i shërbimit**
 - Të mbështesë fëmijët, të rinjtë dhe familjet në situata të vështira social-ekonomike.
- **Fushat e shërbimeve**
 - Shërbime sociale
 - Shërbime ligjore
 - Parandalimi i braktisjes së fëmijëve nga familja
- **Llojet e shërbimeve**

Shërbime sociale:

 - Ofrimi i mbështetjes psiko-sociale për fëmijët, familjet dhe individët në nevojë;
 - Mbështetje me programe për aftësim profesional dhe orientimin drejt punësimit të prindërve dhe të të rinjve;
 - Ofrimin e qasjes në rrjetet e shërbimeve në komunitet për fëmijët dhe familjet;
 - Mbështetje përmes programit të studimit pas-shkollor për fëmijët në nevojë.

Shërbime ligjore:

 - Mbështetje ligjore dhe administrative për familjet dhe individët në nevojë;
 - Informim mbi të drejtat, këshillim dhe advokim për familjet dhe individët në nevojë;

Parandalimi i braktisjes së fëmijëve nga familja:

- Aktivitete ndërgjegjësuere për shërbimin e kujdestarisë alternative dhe mirëqenien e fëmijëve;
- Ofrimi i kujdesit afatshkurtër social në shtëpi për fuqizimin e familjes;
- Fuqizim i familjeve kujdestare me dhe pa lidhje gjaku për mirërritjen e fëmijëve;
- Kurse prindërimi me qëllim përforcimin e aftësive prindërore;

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese

- Fëmijët
- Familjet
- Prindërit (brenda familjes në fokus)

Kriteret kualifikuese

- Familje në rrezik për institucionalizimin e fëmijëve të tyre;
- Familje me vështirësi të theksuara ekonomike;
- Familje me vështirësi të theksuara sociale (prindër të divorcuar, nëna kryefamiljare, nëna-vajza, me një prind të ve, etj);
- Familje me vështirësi të theksuara në ushtrimin e prindërimit që ndikojnë në zhvillimin e fëmijës dhe dinamikave familjare;
- Familje me anëtarë me probleme të shëndetit mendor apo fizik, përdorues dhe/ose abuzues të lëndëve alkolike/narkotike, me aftësi ndryshe;
- Familje kujdestare në nevojë për të përballuar përshtatjen me fëmijën apo menaxhimin e sjelljeve të tij/saj;
- Familje të reja, të izoluar dhe/ose familje pa rrjet mbështetës;
- Familje nga komunitetet Rome dhe Egjiptiane, në vështirësi sociale, ekonomike dhe shëndetësore;
- Fëmijë nga familjet e lartpërmendura;
- Prindër, individë nga familjet e lartpërmendura.

Identifikimi i përfituesve

- Identifikimi kryhet përmes referimeve nga institucionet koordinuese (të përmendura si më poshtë).

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve

- 8 punonjës

Financuesi i shërbimit

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Bashkia Korçë

- Burime të tjera të ardhurash**
 - ↳ Organizatat jofitimprurëse
 - ↳ Projekte të ndryshme që zbatohen në këtë fushë

- Pagesa nga përfituesit**
 - ↳ Nuk ka

- Koordinimi me shërbime të tjera**
 - ↳ Bashkia Korçë, (Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, Njësia për Vlerësimin dhe Referimin e Rasteve, Zyra e Ndihmës Ekonomike, etj);
 - ↳ Institucion arsimor (shërbimet psiko-sociale në shkolla, kopshte, çerdhe, qendra të formimit profesional);
 - ↳ Institucionet shëndetësore të nivelit parësor, dytësor dhe terciar (shërbimet psiko-sociale në qendrat shëndetësore, poliklinika, spitale, maternitet);
 - ↳ Strukturat e policisë apo organet e drejtësisë;
 - ↳ Zyrat e punës;
 - ↳ Organizatat lokale të Shoqërisë Civile

Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor, Korçë

Lloji i institucionit	Publik
Adresa	Lagjja 4, Rruga "Asim Vokshi", Nr. 20
Përfaqësues ligjor i institucionit	Dr. Nikolina Bode Shefe e Shërbimit, Mjeke Psikiatre Cel.: 00355 67 6440923 Email: nikolina.bode10@gmail.com
Personi i kontaktit	Dr. Nikolina Bode Shefe e Shërbimit, Mjeke Psikiatre Cel.: 00355 67 6440923 Email: nikolina.bode10@gmail.com
Mbulimi gjeografik	Bashkia Korçë, Maliq, Devoll, Ersekë
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 2007

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- Qëllimi i shërbimit**
 - Përmirësimi i mirëqënies emocionale, psikologjike dhe sociale për personat që kanë probleme të shëndetit mendor dhe komunitetin në tërësi.
- Fushat e shërbimeve**
 - Shërbim psikologjik
 - Shërbim social
 - Shërbim shëndetësor
- Llojet e shërbimeve**
 - Shërbim psikologjik:**
 - Vlerësime dhe raporte psikologjike;
 - Ofrimi i seancave të psikoterapisë;
 - Mbështetje psikologjike dhe edukim mbi sëmundjen mendore për familjarët;
 - Ndërlidhës me shërbime të tjera sipas nevojave;
 - Shërbim social:**
 - Mbështetje në përgatitjen e dokumentacionit për procedurat e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAËP);
 - Shoqërimi i pacienit në konsulta të tjera mjekësore;
 - Parandalim përmes edukimit shëndetësor individual, në grup dhe komunitet.

Shërbim shëndetësor:

- Ndjekje të rastit dhe menaxhim të medikamenteve;
- Rekomandime për ekzaminime apo ndjekje të mëtejshme;
- Terapi infermierore në qendër, banesë dhe shtëpitë psikiatrike (kryesisht injeksione, mjekime);
- Vlerësim multidisiplinor bio-psiko-social (bashkë me psikologun dhe punonjës social);
- Referim i rasteve të rënda në nevojë për hospitalizim në Spitalin Psikiatrik, Tiranë.

GRUPET PËRFITUESE

- **Kategoritë përfituese** ➤ I gjithë komuniteti
- **Kriteret kualifikuese** ➤ Çdo anëtar i komunitetit me çrregullime të shëndetit mendor
- **Identifikimi i përfituesve** ➤ Përmes sistemit publik shëndetësor të referimit

INFORMACION ADMINISTRATIV

- **Numri i punonjësve** ➤ 12 punonjës (staf multidisiplinar)
- **Financuesi i shërbimit** ➤ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- **Burime të tjera të ardhurash** ➤ Nuk ka
- **Pagesa nga përfituesit** ➤ Nuk ka
- **Koordinimi me shërbime të tjera**
 - Kujdesi Shëndetësor Parësor, përmes qendrave shëndetësore
 - Spitali Rajonal Korçë
 - Drejtoria e Kujdesit Social Bashkia Korçë, Maliq, Ersekë, Devoll
 - Njësitë Administrative të bashkive që mbulon QKSHM Korçë
 - Policia e Shtetit
 - Shkollat dhe komuniteti

O Mary Potter, Kujdesi Shëndetësor Familjar Shërbimi Paliativ

Lloji i institucionit	Organizatë Jofitimprurëse
Adresa	Rruga "Thoma Huaja", Lagjja. 3, Korçë, Shqipëri Tel: +355 822 52711 Email: korcapalliativecare@yahoo.com www.marypotterhospice.al
Përfaqësues ligjor i institucionit	Irena Laska Cel.: +355 69 225 7953
Personi i kontaktit	Irena Laska Cel.: +355 69 225 7953 Email: irenalaska@yahoo.com
Mbulimi gjeografik	Qarku Korçë (rrethi Korçë, Devoll, Kolonjë, Pogradec)
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 2000

● INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- **Qëllimi i shërbimit**
 - Përmirësimi i gjendjes fizike, psiko-sociale dhe shpirtërore për pacientët në fazën terminale dhe lehtësimin e kujdestarëve nga përkujdesja për ta.
- **Fushat e shërbimeve**
 - Shërbim shëndetësor paliativ
 - Shërbim psiko-social për pacientët dhe familjarët
- **Llojet e shërbimeve**
 - Shërbim shëndetësor paliativ:
 - Kujdesi paliativ në shtëpitë e pacientëve
 - Aplikimi i kemioterapisë kurative dhe paliative
 - Terapi ditore në qendër apo në shtëpitë e të sëmurëve
 - Hospisi ditor/ Qendra ditore
 - Mjekime për plagë post-operatore dhe plagë të ndryshme
 - Trajtimi i limfedemave dhe manipulime të ndryshme
 - Analiza/ ekzaminime laboratorike
 - Shërbim psiko-social për pacientët dhe familjarët:
 - Mbështetje psikologjike për pacientët;
 - Mbështetje psikosociale për familjarët, biseda, takime;
 - Informim të familjarëve për ecurinë e sëmundjes;
 - Informim dhe shoqërim i familjarëve për procedurat e përfitimeve sociale;
 - Përgatitje e familjarëve për procesin e vdekjes;
 - Kujdes për familjarët në periudhën e zisë.

GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese**
 - ↘ Individët
 - ↘ Familjet
 - ↘ Komuniteti
- Kriteret kualifikuese**
 - ↘ Të sëmurët me kancer në stad të avancuar
 - ↘ Familjarë të të sëmurit në fazë terminale
 - ↘ Anëtarë të komunitetit të interesuar në shërbimet laboratorike të Qendrës
- Identifikimi i përfituesve**
 - ↘ Institucionet koordinuese (sikundër përshkruhen më poshtë)
 - ↘ Komuniteti, familjarët, etj. që kanë kontakt me të sëmurin

INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve**
 - ↘ 17 persona
- Financuesi i shërbimit**
 - ↘ Urdhri i Krishterë i misionarëve “Mary Potter” (Little Company of Mary Sisters) me qendër në Londër.
- Burime të tjera të ardhurash**
 - ↘ Donacione dhe projekte të ndryshme.
- Pagesa nga përfituesit**
 - ↘ Nuk ka (për të sëmurët terminalë)
 - ↘ Komuniteti i gjerë paguan për shërbimet laboratorike
- Koordinimi me shërbime të tjera**
 - ↘ Spitali Rajonal Korçë, Shërbimin Onkologjik
 - ↘ Qendra Studentore Universitare Tiranë
 - ↘ Kujdesi Shëndetësor Parësor
 - ↘ Shërbimi i Kujdesit Social, Bashkia Korçë
 - ↘ Organizata të tjera rajonale, ndërkombëtare, etj.

○ Fondacioni “Mëshirë pa kufi për Shqipërinë”

Qendra Komunitare Ditore

Lloji i institucionit	Fondacion (Organizatë fetare e Krishterë)
Adresa	Rruga “Ajet Gjondolli”, Lagjja nr. 17, Korçë
Përfaqësues ligjor i institucionit	Daniela Drabo Cel.: +355 69 924 6293 Email: MOd_drabo@yahoo.com
Personi i kontaktit	Daniela Drabo Cel.: +355 69 924 6293 Email: MOd_drabo@yahoo.com
Mbulimi gjeografik	Bashkia Korçë, Maliq, Ersekë, Devoll, fshatrat e Pogradecit
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 2017

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- **Qëllimi i shërbimit** ➤ Personat dhe familjet vulnerabël të kenë mundësi të jetojnë me dinjitet dhe shpresë
- **Fushat e shërbimeve** ➤ Shërbime përmes Qendrës Komunitare Ditore
➤ Shërbime humanitare
- **Llojet e shërbimeve** **Shërbime përmes Qendrës Komunitare Ditore:**
➤ Ofrim i mensës ditore për të moshuarit e vetmuar, familjet në nevojë, personat me probleme të shëndetit mendor, etj;
➤ Ofrimi i vakteve ushqimore nëpër shtëpi për personat e pamundur;
➤ Shërbimi i dusheve dhe lavanterisë për të pastrehët, të moshuarit, ata që nuk kanë mundësi higjienizimi në shtëpitë e tyre, etj..

Shërbime humanitare:
➤ Ndiurma me ushqime, veshmbathje, orendi shtëpiake, dru, medikamente;
➤ Ushqim specifik për bebet e porsalindura;
➤ Sete për higjienë personale dhe shtëpiake (detetergjentë, pelena njëpërdorimshe për personat e paralizuar).

○ GRUPET PËRFITUESE

- **Kategoritë përfituese** ➤ Të moshuarit
➤ Individët
➤ Familjet

- **Kriteret kualifikuese**
 - Të moshuar të vetmuar
 - Individë në gjendje të vështirë ekonomike
 - Të pastrehë
 - Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të ulta
 - Familjet e varfëra me numër të lartë anëtarësh
 - Personat me Aftësi të Kufizuara
 - Personat me probleme të shëndetit mendor
- **Identifikimi i përfituesve**
 - Përmes institucioneve koordinuese (sikundër përshkruhen më poshtë)

○ INFORMACION ADMINISTRATIV

- **Numri i punonjësve**
 - 1 person + vullnetarë
- **Financuesi i shërbimit**
 - Besimtarë të Kishave Ungjillore në Shqipëri dhe Norvegji.
 - Organizata “New Strat for East”, përmes dhurimeve.
- **Burime të tjera të ardhurash**
 - Aktiviteti ekonomik i vetë Fondacionit
- **Pagesa nga përfituesit**
 - Nuk ka
- **Koordinimi me shërbime të tjera**
 - Drejtoria e Kujdesit Social në Bashki
 - Njësitë Administrative
 - Shërbimi i Shëndeti Mendor pranë Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor
 - Shërbimi Social në Qendrat Shëndetësore të Kujdesit Shëndetësor Parësor
 - Shërbimi Social në Spitalin Rajonal Korçë
 - Shërbimi Social Shtetëror Rajonal, Korçë
 - Kisha Ungjillore
 - Organizata të tjera të Shoqërisë Civile

○ Fondacioni Kennedy

Qendra Ditore për Fëmijët

Lloji i institucionit Fondacion

Adresa Lagjja 12, Rruga "Niko Dodona", Nr 6, Korçë, Shqipëri

Përfaqësues ligjor i institucionit **Albano Kadi**
Cel.: +355 69 207 3810 | Email: albanokadi@gmail.com

Personi i kontaktit **Erion Jonusllari**
Cel.:+355 69 404 0784 | Email: erionjonusllari@gmail.com

Mbulimi gjeografik Qyteti Korçë

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 2004

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

○ **Qëllimi i shërbimit** ➤ Mbështetje dhe fuqizim i fëmijëve me probleme social-ekonomike

○ **Fushat e shërbimeve** ➤ Shërbime psiko-sociale

○ **Llojet e shërbimeve** Shërbime psiko-sociale:
➤ Mbështetje për nevojat bazë të fëmijëve (ofrim i vaktit të drekës, ushqime në familje, medikamente);
➤ Edukim dhe argëtim për fëmijët (ndihmë me detyrat e shkollës, aktivitete argëtuese, socializuese dhe edukuese, ofrim të mjeteve shkollore);
